

Tiranë, më 3.11.2023

Njoftim për shtyp

Komisioneri Publik, brenda afatit ligjor, ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, kundër vendimit nr. 702, datë 27.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Agron Bushati, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkodër.

Komisioneri Publik, pas shqyrtimit të vendimit nr. 702/2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë, pasi me shkeljet e konstatuara dhe me sjelljet joetike, ai ka cenuar besimin e publikut ndaj drejtësisë.

Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 702, datë 27.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Agron Bushati.

Mbështetur në pikën 1, të nenit 16, të rregullores së Institucionit të Komisionerëve Publikë, ankimi është publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni: <http://ikp.al/ankime>

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisionerët Publikë përfaqësojnë interesin publik gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.